



27.07.2021

REPUBLICA E KOSOVES - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA E KOSOVË - OPSTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
KONTAKT NE DOREZIM PRILUJENI RECEIVED			
Kënaq. org. / Org. Unit	Numri / Number	Shënim / Remark	Vlera / Value
01	351	41895	7

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 624-21-3054-5-2-1/C649

KOMUNA SUHAREKË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Vehbi Mamaj B.I., Rr. Skënderbeu, pn, Suhareke, me numër unik identifikues 811038117 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Zhvillimi i turizmit rural Guida digjitale dhe shtegu i ecjes-Mushtisht, Delloc. me numër identifikues: 624-21-3054-5-2-1 & 624-021-090 -521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Zhvillimi i turizmit rural Guida digjitale dhe shtegu i ecjes-Mushtisht, Delloc.**

No.	Lot
1	Zhvillimi i turizmit rural Guida digjitale dhe shtegu i ecjes-Mushtisht, Delloc.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **18 840,00 €**; Tetëmbëdhjet mij e tetëqind e katërdhjetë Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave të dorëzuara së bashku me situacionin dhe raportin e nënshkruar nga menaxheri i kontratës, në llogarinë bankare të OE.

2.5 Pagesa e fundit në vlerë jo më pak se 10 % e vlerës së kontratës do të bëhet me raportin e pranimit të punëve nga Menaxheri i Kontrates dhe mbikqyresi i drejtëpërdrejtë i Menaxherit.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Afrim BYTYQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	23.07.2021
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Vehbi Mamaj
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	
Data:	23.07.2021
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 624-21-3054-5-2-1/C649

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIP
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 1,884.00 EURO me validitet deri me 02.10.2021
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 23.07.2021
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 02.09.2021
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: Menaxheri i caktuar me vendim te ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është: Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë pas pranimit të punëve nga ana e Menaxherit dhe mbikqyresit të drejtëpërdrejt të menaxherit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMAËSA DHE PARALLOGARIA L=5500M

POS	Pershkrimi i pozitimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
1	Punët Përgaditore				
1	Shënimi, pikëtimi i rrugëve matje gjeodezike-sipas matjeve kadastrale të trases së rrugës fushore	m	5,500.00	0.10	550.0
2	Punët Demoluese				
2.1	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat e ngurta, shkurret drunjet dhe rrethojat në zonat ku do të kalojë traseja e rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtuesin e rrugës me gjeresi të përcaktuar b=5-6 cm sipas profilin tërthor si dhe largimin e tyre në deponi Deponimin e materialit të demoluar e cakton investitori 1 log m m ²	m ²	27,500.00	0.05	1,375.0
2.2	Punët Tokësore				
3.1	Germimi i dheut të kategorisë III-IV, deri në thellësi dhe me gjeresi b=5-6 cm, të nevojshme për punë duke përfshirë të gjitha pikat gjeodezike.	m ²	27,500.00	0.10	2,750.0
3.2	Punimi i kanalit të hapur anësor për largimin e ujrave atmosferik në formë trapezoid në të njëjtë të rrugës	m ¹	5,500.00	0.10	550.0
3.3	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës (para mbushjes) me trashësi dhe ngjeshje, si dhe rregullimi i pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore të rrugëve	m ²	27,500.00	0.10	2,750.0
3.4	Mbushje për nivelizimin e trases së rrugës nga dheu i germuar I kategorisë II dhe IV me ngarkim dhe bartje nëpër trasë me shtrirje dhe ngjeshje me cilindër vibruar në shtresë deri 20 cm, për nivelizimin e trases së rrugës.	m ²	27,500.00	0.05	1,375.0
					9,350.0
4	Pjesa sipërfaqësore (mbushja) e rrugës				
4.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së bazës së rrugës nga gurë natyral, aty ku është e nevojshme si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibruar	m ³	500.00	3.00	1,500.0
4.2	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavori nga gurë të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtresës t=15 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibruar derisa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=400 kg/cm ² . Sërim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtojë testin modul të ngjeshjes dhe ta prezantojë tek menaxheri i kontratës	m ³	1,500.00	3.00	4,500.0
					6,000.0
5	Punët e lëshesave (Tombinave)				
5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e lëshesave (tombinave) rrethore prej gypave Ø500 të parapregaditura nga betoni, kokat hyrë dhe dalje të lëshesave të përgaditura dhe punohen nga kallopët prej drasave BA C25/30.	m	230.00	10.00	2,300.0
6	Hapja e kanaleve horizontale dhe vendosja e gypave li-500 në proekat sipas nevojës bager me fuqi 5-15 t	orë	17.00	70.00	1,190.0
					3,490.0
			TOTALI		18,840.00 €

